



Pranuar / Dorezuar Priljenat/Prudato Received/Deliverty	01.09.2022	2	viti god veq.
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5066/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.590/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.590/2022 të datës 04.07.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ përmes përfaqësuesit të autorizuar avokati _____ me adresë rruga _____ kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “Ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 01.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.590/2022 e datës 04.07.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.nr.027/2022 i datës 14.06.2022 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ punësuar në pozitën “Zyrtar Korrektues , në Qendrën Korrektuese në Dubravë” sipas kontratës së punës për kohë të caktuar të datës 12.06.2018, me vendimin KD.nr.027/2022 e datës 14.06.2022 Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës i shqipton masën disiplinore “Largimi nga Shërbimi Civil”.

Ankuesi kundër vendimit KD.nr.027/2022 e datës 14.06.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3881/2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 07.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datë 19.07.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/38.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 15.08.2022 ka nxjerr vendimin VK.nr.79/2022 për shtyrje të afatit edhe për 10 (dhjetë) ditë pune të ankesës A.nr.590/2022 të datës 04.07.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.590/2022 me numër të protokollit 3881/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 04.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit KD.nr.027/2022 e datës 14.06.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Deklarata e datës 06.05.2022; Udhëzimi Administrativ MD-Nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 15.01.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 03.12.2020; Autorizimi i datës 04.07.2022; Parashtresë e datës 22.07.2022 me numër protokollit 4238/2022 bashkë me peticionin e sindikatës së qendrës korrektuese në Dubravë për Zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit korrektues të Kosovës; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 19.07.2022 me numër protokollit 4193/2022 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/38; Kontrata së punës për kohë të caktuar të datës 12.06.2018; Rekomandimi për përtëritjen e kontratës i datës 12.04.2018; Përshkrimi i detyrave të punës; i datës 03.01.2020; Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore; E-mail zyrtar i datës 10.05.2022; Tri foto të bëra me datën 06.05.2022 në ora 10:51; Procesverbal i datës 25.05.2022; Porta "0" detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarit-es në pranimin dhe identifikimin e vizitorëve; Porta "0" detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarit /es korrektues në recepcion (pranimin e gjërave për të burgosur të sjellura nga familjarët): Hyrjet në Qendrën Korrektuese Dubravë prej datës 02.05.2022-08.05.2022; procesverbali i intervistës me stafin -A.B e datës 08.06.2022; Raport për bastisje pozitive i datës 06.05.2022; Qendra e vizitave-detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarit korrektues në bastisjen e vizitorëve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Ankuesi _____ i punësuar në pozitën "Zyrtar Korrektues , në Qendrën Korrektuese në Dubravë" në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, sipas kontratës së punës për kohë të caktuar të datës 12.06.2018, në bazë të raportit për bastisje pozitive të datës 06.05.2022 është konstatuar se gjatë monitorimit të kamerave nga oficeri i dhomës së kontrollit është vërejtur se vizitori Sh.K i cili kishte ardhur për ta vizituar të burgosurin B.R gjatë shfrytëzimit të vizitës familjare i ka dhënë diçka të dyshimtë të burgosurit B.R, dhe menjëherë është njoftuar stafi i sallës së vizitave për të bërë bastisjen e të burgosurit B.R ku edhe sipas këtij raporti të inicimit të procedurës disiplinore, të burgosurit B.R i janë gjetur 3 telefona mobil, 1 USB, 2 kablllo për mbushjen e telefonave mobil si dhe 2 Sim kartela të Vales, ndërsa është konstatuar se ankuesi kishte qenë zyrtari përgjegjës që kishte kontrolluar të njëjtin dhe nuk kishte vërejt se posedon

DS
SHK
DSO
21
SH
KFR

pajisje të ndaluara dhe që nuk lejohen të kishte në posedim brenda kësaj hapësire ndërsa ankuesi gjatë bastisjes me prekje të vizitorit Sh.K me ose pa qëllim ka lejuar që i njëjti të kaloj duke poseduar gjëra të fshehta të ndaluara që të depërtojnë në sallën e vizitave përkatësisht te i burgosuri B.R të cilat gjësende të mbështjella arrin ti merr i burgosuri në fjalë. Pas këtij incidenti Zëvendësuesi i Zv.Drejtorit të QKD-së(Qendrës Korrektuese në Dubravë) ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje disiplinore të paraparë me nenin 46 paragrafi 3,nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe shkelje të rregullave të brendshme të punës , Kodit të Disiplinës 9.2 Standardi i parë pika 4f, me këtë rast i njëjti kërkon inicim të procedurës disiplinore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjithnjë duke u bazuar në arsyetimin e vendimit të komisionit disiplinor analizoi me kujdes elementet e dëshmisë së dëshmitarëve të dhënë pranë Komisionit Disiplinor,dhe at udhëheqëses së vizitave znj A.B dhe mbikëqyrësit të vizitave z.A.A, fotot e imazheve të pajisjeve dhe deklaratën e Ankuesit dhënë në intervistën e pranë Komisionit disiplinor me datën 25.05.2022 i cili ka deklaruar se bastisjen e ka bërë me prekje fizike ndërsa detektorin nuk e ka përdor sepse sipas tij nuk ka pasur obligim ligjor dhe se nga deklarimi nuk ka arrit të shpjegojë se pse nuk është përdor detektori siç është i përcaktuar me detyrat që ka zyrtari në bastisje, ndërsa në ankesën e parashtruar ankuesi kërkon që pasi mjetet e ndaluara të cilat kanë qenë në posedim të shkurtër tek i dënuari me inicialet SH.K dhe fare nuk janë përdorur nga i njëjti duhet të merrej parasysh nga ana e Komisionit Disiplinor,dhe mbi këtë bazë kolegji i këshillit konstaton se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave ligjore të ligjit të zyrtarëve publik akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj si dhe rregullave të brendshme të institucionit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi nuk e ka kryer punën gjatë vizitës me vizitor ashtu siç parashihet në detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarit korrektues gjatë bastisjes së vizitorëve nga se në përshkrimin e detyrave të tij, dokumentë të cilin e ka sjellë organi i punësimit ndërsa në pikën 2 të këtij dokumenti parashihet: *"Detyrë e zyrtarit /es është të kryej bastisjen në mënyrë korrekte dhe profesionale me anë të detektorit të dorës si dhe me fërkim (prekje) për të gjithë vizitorët pa përjashtim"* andaj bazuar në provat e lëndës dhe deklaratave të ,udhëheqëses së vizitave, mbikëqyrësit të vizitave si dhe në përshkrimin e vendit të punës që u specifikue më lartë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se gjatë bastisjes me prekje fizike nga ankuesi duke mos aplikuar edhe detektorin e dorës me rastin e kontrollit kanë depërtuar deri te personi i dënuar: 3 smart telefona mobil (samsung),2 sim kartela telefonike dhe dy kablllo për mbushje të telefonave, gjithnjë sipas konstatimit në arsyetim të vendimit të komisionit disiplinor. Pas këtij incidenti Zëvendësuesi i Zv.Drejtorit të QKD-së(Qendrës Korrektuese në Dubravë) ka konstatuar se ky veprim është në kundërshtim me parimet dhe rregullat në ushtrimin e përgjegjësive në punë dhe bien ndeshë me nenin 46 paragrafi 3,nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe shkelje e rregullave të brendshme të punës brenda institucionit përkatësisht Kodin e Disiplinës nenin 9.2 Standardi i parë pika 4f, sepse një veprim i tillë është rreptësisht i ndaluar me Rregulloren e Brendshme të Punës, me konkretisht me standardin e katërt pikë g ku thuhet: *"fut apo nxjerr nga burgu kontrabandë apo sene të palejuara"*, kështu që ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 07/2015 dhe Kodit të Etikës Profesionale për Zyrtarët Korrektues në

Shërbimin Korrektues të Kosovës, sepse zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës siç parashihet me nenin 25 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike"*, po ashtu sipas nenit 26 paragrafi 1; *"1. Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyresit e tij sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit"*, ndërsa poashtu veprimet e ankuesit në këtë rast bien ndeshë me dispozitat e nenit 28 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase specifikishtë parashihet; *"1. Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij"*, andaj mbi këto baza ligjore kolegji konstaton shkelje të këtyre dispozitave nga ankuesi me rastin e mos ushtrimit të detyrave konformë këtyre dispozitave ligjore të specifikuara më lartë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në pretendimin ankimor dhe duke marrë për bazë Vendimin me Nr. 0639 të datës 11.02.2022 në bazë të të cilit është themeluar Komisioni Disiplinor në përbërje: A.M-Kryesues i Komisionit Disiplinor, S.M -anëtar i komisionit dhe M.S-anëtar i Komisionit, bazuar në këtë z. A.M mban pozitën Udhëheqës për Administratë, S.M -zyrtar korrektues dhe M.S -zyrtare e burimeve njerëzore, dhe konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit se Vendimi për themelimin e Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës është në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik është i pabazuar.

Poashtu kolegji duke ju referuar pretendimeve ankimore të ankuesit se me rastin e inicimit të procedurës disiplinore janë shkelë dispozitat e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nenit 48 paragrafi 4.1 dhe në kundërshtim me rregulloren (QRK)nr.11/2020 për Disiplinë dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik nenin 7 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe 6, konstaton se sipas Ligjit n.06/L-114 për Zyrtarët Publik parashihet se komisioni disiplinor fillon procedurën disiplinore bazuar në nenin 48 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2, të cilat dispozita specifikishtë parashohin; *"Me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit"* dhe mbi këtë bazë duke pasur parasysh elementin e kontrollit hierarkik të nëpunësit që ka iniciuar procedurën disiplinore kolegji konstaton se pretendimi ankimor i kësaj natyre është i pabazuar, ndërsa poashtu kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës nuk ka hasur në ndonjë elementë që bie ndeshë me nenin 48 paragrafi 6 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik me rastin e procedurës disiplinore.

Në bazë të këtyre dispozitave të potencuara si më lartë, meqenëse ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore, atëherë Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrës së Vendimin KD.NR.027/22 të datës 14.06.2022, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1,1.2,1.3,1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: *"1.1.ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo*

mosveprimit; 1.2.kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3.ndodhja e pasojës; 1.4.ndodhja e dëmit dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”, mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse është shqiptuar në raport të drejtë me shkeljen e kryer, rrjedhimisht komisioni disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”, si dhe nenin 13 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 dhe paragrafin 3 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit se masa disiplinore e shqiptuar është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi janë të pabazuara.

Gjithashtu me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese kolegji kishte pasur në shqyrtim edhe shkresën e sindikatës të datës 22/07/2022 si dhe poashtu konstaton se ankuesi sipas vlerësimit të vitit 2020 dhe 2021 ishte i vlerësuar shumë mirë dhe se nuk kishte të aplikuar ndonjë masë disiplinore ndaj tij, gjithnjë duke u bazuar në shkresa të lëndës mirëpo me qenë se kemi të bëjmë me veprim të natyrës që cilësohet si shkelje e rëndë sipas legjislacionit në fuqi atëherë nuk kishin efektin e mjaftueshëm për ti trajtuar edhe këto elemente që në rrethana tjera do të mund të ishin me efekt në vendimmarrje.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.590/2022, datë 01/09/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ *Përfaqësuesit të ankuesit, Avokatit*
- ❖ *Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- ❖ *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe*
- ❖ *Arkivit të KPMSHCK-së*